

AKTI I THEMELIMIT

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“BLACK EAGLE ALBANIA ” Shpk

Une Arbër Xhaja i datelindjes 13.02.1984 , banues ne Lagjen Nr.9 “Mine Peza Tirane “ , i identifikuar nga leternjoftimi elektronik me Nr.**034702292** dhe ID **I40213111C** qe ne vijim do te quhet “**Ortak**”

Sot me date 22.05.2024 , vendosa te themeloj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar “**BLACK EAGLE ALBANIA ” Shpk** ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti I veprimtarise se shoqerise :

1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie: Aktivitete te tjera sportive ,Motorra me Qira , Marketing nepermjet fluturimit ,fluturime Turistike

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj,

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaku I vetem vendosi qe shoqerine ta emertoje

“BLACK EAGLE ALBANIA ” Shpk

2.2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne : Kavaje ,Njesia Administrative Golem ,Fshati Qerret , Rruga “Stanit te Ri ” ,Z.Kadastrale 3101 Mjeti me targe **AB 569 II**

2.3. Shoqeria mund te krijoj qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

3.2. Me vendim të tij Ortaku i vetëm mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, n.q.s në të ardhmen krijohen premisa me të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Ortaku do të përshtatet Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjë regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe në përputhje me ligjin

3.4. Shoqëria do të ketë vullnet të saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakut

4.1. Shoqëria ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj .

4.2. Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të përbashkëta në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.

4.5. Ortaku ka të drejtë të marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj

4.6. Ortaku ka të drejtë të bëjë propozime, si dhe emerojë e shkarkojë, administratorin ose administratorët, punonjësit, ekspertin kontabil, apo likuidatorët

Neni 5

Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar

Kreu III
KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte **100.000** (njqind mije) leke dhe eshte i ndare ne 1 kuote me vlere nominale **100.000 leke** secila prej tyre

6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :

Arbër Xhaja 1 kuote , perkatesisht 100% te kuotave.

Kreu IV
ORGANET E SHOQERISE

Neni 7

7.1. Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaku i Vetem ne Asamblene e Pergjithshme.Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise.Administratori i Shoqerise dhe ekspeti kontabel I autorizuar caktohen nga Ortaku i Vetem I shoqerise

Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1.Administrimi I shoqerise do te behet nga **Administratori. Z, Arbër Xhaja**

8.2. Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte riprteritje ne perfundim te mandatit

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

9.1. Fitimi I realizuar nga Shoqeria , mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet Ortakut te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

9.2.Ky Akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise

ORTAKU I Vetem SHOQERISE “ BLACK EAGLE ALBANIA ” Sh.p.k

Arbër Xhaja

